

Qendra e Botimeve për Diasporën dërgon tekstet mësimore falas në Diasporë



Qendra e Botimeve për Diasporën, për të dytin vit radhazi, nisi dërgimin e teksteve mësimore në Diasporë, në përmbushje të misionit së saj themelor, atë të pajisjes me tekste mësimore dhe materiale plotësuese të gjuhës e kulturës shqiptare, falas për shkollat e gjuhës shqipe. Falë një pune të madhe dhe të përkushtuar përgatitore, në bashkëpunim ndërinstitucional me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Postën Shqiptare, si dhe nën kujdesin e veçantë të Ministrit të Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, mbi 17 mijë tekste shkollore dhe plotësuese për shkollat e gjuhës dhe të kulturës shqiptare në Diasporë, janë të paracaktuara për të mbërritur te nxënësit dhe mësuesit e shkollave të gjuhës dhe kulturës shqiptare të 21 vendeve të botës, për vitin 2020-2021 brenda muajit shtator. Njëkohësisht, përpos teksteve shkollore, Qendra e Botimeve për Diasporën vjen edhe me një tjetër risi, me serinë e saj të botimeve dygjuhëshe. Këtë vit nxënësit e shkollave shqipe do të pajisen dhe me fjalorët dygjuhësh shqip-anglisht, shqip-italisht, shqip-greqisht, shqip-ukrainisht, si dhe me përrallat klasike dygjuhëshe shqip-anglisht, shqip-italisht dhe shqip-greqisht, të hartuara si materiale plotësuese për mësimdhënien dhe të botuara rishtas nga QBD-ja. Këtë javë u nisën dërgesat e para për në Gjermani, Zvicër, Çeki, Francë, Turqi, Belgjikë, Spanjë dhe Rumani.

Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko, reagon me një falënderim për menaxhimin e krizës në Kakavijë



Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, nëpërmjet një reagimi në "Facebook" ka falënderuar ministren znj. Olta Xhaçka dhe ministrin z. Sandër Lleshi për punën që kanë bërë gjatë ditëve të fundit në situatën kaotike që ishte në Kakavijë. Nuk ka munguar as falënderimi për Anastas Janullatos i cili është angazhuar personalisht që situata të shkonte drejt zgjidhjes. Krizës në Kakavijë i erdhi fundi ku u lejuan që të kalonin të gjitha makinat që ishin në radhë.

Vota e Diasporës Shqiptare



Të interesuarit për të drejtën e votes në migracion, mund të gjejnë propozimet që i janë dërguar Komisionit të Reformës Zgjedhore [këtu](#):

"Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës"



"Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës" është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetimin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionale të ndryshme në diasporë.

Përfaqësitë diplomatike shqiptare në botë vazhdojnë promovimin e platformës "Rrjeti i Profesionistëve"

RRJETI I PROFESIONISTËVE

është një portal që synon të mbështesë e të nxisë zhvillimin e Shqipërisë duke ofruar një urë lidhëse për Diasporën, me qëllim për të mbledhur dhe shkëmbyer informacione dhe përvojat e ekspertizës së anëtarëve të këtyre komuniteteve në të mirë të zhvillimit të vendit si dhe në drejtim të generimit të ideve dhe nisurave me përfundim të përbashkët për anëtarët e këtyre komuniteteve.

BËHU PJESË E RRJETIT

www.rrjetiprofesionisteve.al +355 (0) 44502150 info@rrjetiprofesionisteve.al



Përfaqësitë diplomatike shqiptare në vende të ndryshme të botës vazhdojnë promovimin dhe mbështetjen e tyre ndaj platformës "Rrjeti i Profesionistëve": <http://rrjetiprofesionisteve.al/>, nismë e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës. Ambasadat shqiptare u bëjnë thirrje të gjithë profesionistëve shqiptarë në Diasporë të bëhen pjesë e Rrjetit për tu takuar me njëri-tjetrin në një hapësirë profesionale dhe bashkëpunuese.

Platforma Digjitale e Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për here të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen.

KKD takim online me Organizatën "Germin"



Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës kanë zhvilluar një takim online me Organizatën "Germin". Gjatë takimit u diskutuan çështjet me rëndësi për Diasporën shqiptare dhe mundësitë e bashkëpunimit.

KKD / Mark Gjonaj flet për zgjedhjet në Mal të Zi: "Të bashkuar jemi më të forte"



Mark Gjonaj, kryetar i Këshillit Koordinues të Diasporës dhe njëkohësisht këshilltar i Bashkisë së Nju Jork-ut flet për zgjedhjet në Mal të Zi se "Zgjedhjet e 30 Gushtit janë një moment historik për shqiptarët në Mal të Zi, që edhe pse të ndarë tashmë në dy lista, të mund të votojnë shqip që të sigurojnë një përfaqësim më gjithëpërfshirës dhe të denjë të shqiptarëve në parlamentin e Malit të Zi", deklaroi në një intervistë për ATSH, Mark Gjonaj i konsideron historike zgjedhjet e 30 Gushtit 2020 që do të përcaktojnë edhe ekzistencën dhe vazhdimësinë shqiptare në Mal të Zi. Gjonaj thotë se Diaspora është në të vërtetë thesari më i madh jo vetëm i Shqipërisë, por i shqiptarëve në trojet tona etnike.

Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"

SHKARKO APLIKACIONIN FALAS



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

"Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):